



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1076/ Prot.
7

Tiranë më 10.10.2023

VENDIM

Nr. 44, datë 09.10 2023

“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Fizikë dhe Shkenca Kompjuterike”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT, për vitin akademik 2024-2025”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 80; Udhëzimin e MASR-së Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL”, Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkresat Nr. 165/18 Prot., datë 07.04.2023 dhe nr. 165/20 prot., datë 29.06.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 09.10.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Fizikë dhe Shkenca Kompjuterike”, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të UT-së sipas dokumentacionit bashkëngjitur, për vitin akademik 2024-2025.
2. Vendimi i Senatit Akademik t’i përcillet Bordit të Administrimit për veprim.
3. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Fizikë dhe Shkenca Kompjuterike”.
4. Dokumentacioni përkatës të ngarkohet në platformën e-Albania për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
5. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha